



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

QENDRA E SHERBIMEVE ARSIMORE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2021

ME ZGJEDHJE

SKEMA E VLERËSIMIT

LËNDA: HISTORI

VARIANTI A

Përgjigjet e sakta për çdo pyetje të testit

Pyetja 1	C	1 pikë
Pyetja 2	B	1 pikë
Pyetja 3	C	1 pikë

Pyetja 4 2 pikë

Model përgjigjeje

- Mbretëria Molose
- Lidhja Molose
- Aleanca Molose
- Lidhja Epiriote
- OSE**
- Faza federative
- Faza monarkike
- Faza republikane

Kulmin e zhvillimit e arriti nën qeverisjen e Piros

2 pikë Nëse jep një nga fazat dhe kulmin e zhvillimit ose dy nga fazat

OSE

1 pikë Nëse jep një nga fazat ose kulmin e zhvillimit

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 5 **2 pikë****Model përgjigjeje**

- Fillimisht plebenjtë nuk ishin të përfaqësuar në institucionet romake pasi konsujt dhe senati zgjidheshin vetëm nga rradhët e shtresës së patricëve.
- Më pas, me përpjekjet e tyre dhe me anë të secesioneve, plebenjtë e avancuan pozitën e tyre duke fituar të drejtën për të pasur përfaqësuesit e tyre në senat, të quajtur "tribunë" që mbronin interesat e plebenjve dhe ishin të paprekshëm.
- Tribunët mund të ndalonin veprimet e padrejta të konsujve ose senatit në dëm të plebenjve duke përdorur të drejtë e vetos.
- Më vonë fituan të drejtën që njëri nga dy konsujt romak të ishte nga rradhët e plebenjve.
- Etj.

Shënim: Pranohet çdo lloj përgjigjeje që i përmbahet kërkesës së pyetjes.

2 pikë Nëse shpjegon dy nga arritjet e përfaqësimit të plebenjve.

OSE

1 pikë Nëse shpjegon një nga arritjet e përfaqësimit të plebenjve.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 6 **B** **1 pikë**

Pyetja 7 **D** **1 pikë**

Pyetja 8 **D** **1 pikë**

Pyetja 9 **D** **1 pikë**

Pyetja 10 **2 pikë****Model përgjigjeje**

- Dekreti ikonoklast që shkaktoi çarje mes kishave.
- Lufta për influencë në territore të ndryshme sidomos në Italinë e Jugut.
- Ndryshime të rregullave fetare.
- Përdorimi i dy gjuhëve dhe kalendarëve të ndryshëm.
- Kontrolli i kishës lindore nga perandori bizantin.
- Etj.

Shënim: Pranohet çdo lloj përgjigjeje që i përmbahet kërkesës së pyetjes.

2 pikë Nëse jep dy prej shkaqeve;

OSE

1 pikë Nëse jep një prej shkaqeve;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 11 **A** **1 pikë**

Pyetja 12 **B** **1 pikë**

Pyetja 13 **A** **1 pikë**

Pyetja 14 **A** **1 pikë**

Pyetja 15 **D** **1 pikë**

Pyetja 16 **D** **1 pikë**

Pyetja 17 **3 pikë****Model përgjigjeje**

Të përbashkëtat:

- Funksiononin si shtet brenda shtetit osman.
- Zgjeruan territorin e tyre.
- Vendosën marrëdhënie ndërkombëtare me fuqitë evropiane.
- Në territorin e të dy pashallëqeve përveç popullsisë shqiptare kishte edhe popullsi të huaj.
- Në të dy pashallëqet respektohej toleranca fetare dhe ajo etnike.
- Etj.

Të veçantat:

- Pashallëku i Shkodrës u drejtua nga përfaqësuese të familjes së Bushatllinjve, ndërsa ai i Janinës u drejtua vetëm nga Ali Pashë Tepelena etj.
- Pashallëku i Shkodrës mori pjesë në shtypjen e atij të Janinës.
- Pashallëku i Shkodrës formoi "Konfederatën Ilirike".
- Etj

Shënim: Pranohet çdo lloj përgjigjeje që i përmbahet kërkesës së pyetjes.

3 pikë	Nëse jep dy të përbashkëta dhe një të veçantë
OSE	
2 pikë	Nëse jep dy të përbashkëta OSE një të përbashkët dhe një të veçantë
1 pikë	Nëse jep një të përbashkët OSE një të veçantë
0 pikë	Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 18 **3 pikë****Model përgjigjeje**

- Kishte burime natyrore të lëndëve të para.
- Kishte sistem bankar të zhvilluar.
- Kishte një rrjet të dendur transporti ujor të brendshëm.
- Kishte një flotë të fuqishme që i siguronte tregjet për të eksportuar mallrat.
- Procesi i gardhimit që shkaktoi një migrim të brendshëm nga fshati drejt qytetit, duke rritur fuqinë punëtore.
- Shpikjet e reja në makineri dhe pajisje që çuan në rritjen e prodhimit
- Etj.

Shënim: Pranohet çdo lloj përgjigjeje që i përmbahet kërkesës së pyetjes.

3 pikë	Nëse jep tri nga arsyet.
OSE	
2 pikë	Nëse jep dy nga arsyet.
1 pikë	Nëse jep një nga arsyet.
0 pikë	Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 19 3 pikë

Model përgjigjeje

- *Kuptimi i bllokadës kontinentale*

Sipas kësaj politike, vendet evropiane aleate të Francës do të ndërprisnin marrëdhëniet tregtare me Anglinë dhe portet e tyre do të mbylleshin për mallrat angleze. Bonaparti mendonte se duke e izoluar Anglinë tërësisht, ekonomia e saj do të binte në kolaps.

- *Arsyeja*

Anglia ishte një nga shtetet që Bonaparti nuk po e mposhte dot, kështu që në vitin 1806 shpalli politikën e bllokadës kontinentale, për të dobësuar Anglinë duke synuar ta mposhtë atë.

Shënim: Pranohet çdo lloj përgjigjeje që i përmbahet kërkesës së pyetjes.

3 pikë Nëse jep kuptimin e 'bllokadës kontinentale' dhe jep arsyen e kësaj bllokade.

OSE

2 pikë Nëse jep vetëm kuptimin e "bllokadës kontinentale"

1 pikë Nëse jep vetëm arsyen.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 20 A 1 pikë

Pyetja 21 B 1 pikë

Pyetja 22 C 1 pikë

Pyetja 23 C 1 pikë

Pyetja 24 B 1 pikë

Pyetja 25 B 1 pikë

Pyetja 26 B 1 pikë

Pyetja 27 3 pikë

Model përgjigjeje

- OKB u krijua në vitin 1945.
- Dokumenti që shërbeu si bazë për krijimin e OKB ishte "Karta e Atlantikut", në të cilin përcaktohej krijimi i një sistemi të gjerë dhe të përhershëm të sigurisë pas luftës.
- Synimi i krijimit të OKB është ruajtja e paqes dhe sigurisë në botë

3 pikë Nëse gjen vitin e krijimit, dokumentin dhe synimin e organizatës;

OSE

2 pikë Nëse gjen vitin e krijimit dhe dokumentin **OSE** vitin e krijimit dhe synimin **OSE** dokumentin dhe synimin;

1 pikë Nëse gjen vetëm vitin e krijimit, **OSE** vetëm dokumentin **OSE** vetëm synimin e organizatës;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 28

3 pikë

Model përgjigjeje

- Tatimet e jashtëzakonshme të luftës.
- Shtetëzimi i pronës private në industri.
- Kolektivizimi i pronës në fshat.
- Industrializimi socialist.
- Drejtimi i centralizuar me plan unik shtetëror.
- Etj.

Shënim: Pranohet çdo lloj përgjigjeje që i përmbahet kërkesës së pyetjes.

3 pikë
OSE

Nëse gjen tri nga rrugët për krijimin e bazës ekonomike të sistemit socialist në Shqipëri;

2 pikë

Nëse gjen dy nga rrugët për krijimin e bazës ekonomike të sistemit socialist në Shqipëri;

1 pikë

Nëse gjen një nga rrugët për krijimin e bazës ekonomike të sistemit socialist në Shqipëri;

0 pikë

Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 29

3 pikë

Model përgjigjeje

- a) Statusi që Kosova fitoi ishte Qark autonom në kuadër të Serbisë.
- b) Me miratim e Kushtetutës së vitit 1974, Kosova u bë Krahine Autonome, por në kuadër të Serbisë
- c) Kërkesa kryesore ishte marrja e statusit të republikës nga Kosova në kuadër të Jugosllavisë.

3 pikë

Nëse gjen statusin e Kosovës fill pas Luftës, statusin që fitoi me Kushtetutën e vitit 1974 dhe jep kërkesën kryesore të protestave të vitit 1981.

OSE

2 pikë

Nëse gjen statusin e Kosovës fill pas Luftës dhe statusin që fitoi me Kushtetutën e vitit 1974, OSE statusin e pas Luftës dhe jep kërkesën kryesore të protestave të vitit 1981 OSE gjen statusin që fitoi me Kushtetutën e vitit 1974 dhe jep kërkesën kryesore të protestave të vitit 1981.

1 pikë

Nëse gjen statusin e Kosovës fill pas Luftës OSE statusin që fitoi me Kushtetutën e vitit 1974 OSE kërkesën kryesore të protestave të vitit 1981.

0 pikë

Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 30 **3 pikë****Model përgjigjeje**

- Uli tatimin mbi fitimin.
- Reduktoi subvencionet shtetërore për kompanitë publike.
- Shkurtoi shpenzimet publike.
- Kreu privatizime të mëdha.
- Kufizi rolin e sindikatave.
- Etj

Shënim: Pranohet çdo lloj përgjigjeje që i përmbahet kërkesës së pyetjes.

3 pikë Nëse gjen tri nga masat që mori Theçeri në programin ekonomik.

OSE

2 pikë Nëse gjen dy nga masat që mori Theçeri në programin ekonomik.

1 pikë Nëse gjen një nga masat që mori Theçeri në programin ekonomik.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 31 **3 pikë****Model përgjigjeje**

- Lufta ndaj Gjermanisë të përfundonte vetëm me kapitullimin e saj.
- Pas kapitullimit territori i Gjermanisë të ndahej mes aleatëve.
- Gjermania të paguante dëmshpërblimet për dëmet e Luftës.
- Të krijoheshin Organizata e Kombeve të Bashkuara.
- Të krijoheshin Gjykatat Ndërkombëtare për dënimin e krimeve të Luftës.

3 pikë Nëse gjen tri prej vendimeve të konferencës.

OSE

2 pikë Nëse gjen dy prej vendimeve të konferencës.

1 pikë Nëse gjen një prej vendimeve të konferencës.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 32 **3 pikë****Model përgjigjeje**

- Shtylla I: përcakton hapësirat brenda të cilave shtetet anëtare ndajnë sovranitetin e tyre.
- Shtylla II: politikat e përbashkëta të sigurisë dhe të jashtme.
- Shtylla III: bashkëpunimi në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme.

3 pikë Nëse përcakton tri shtyllat

OSE

2 pikë Nëse përcakton dy nga shtyllat

1 pikë Nëse përcakton një nga shtyllat

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 33

3 pikë

Model përgjigjeje

- U zbatua mekanizmi i vetfinansimit të ndërmarrjeve.
- U lejua sektori privat në artizanat dhe tregti
- U lejua marrja e huave nga jashtë
- U lejuan investimet e kapitalit të huaj
- Etj.

Shënim: Pranohet çdo lloj përgjigjeje që i përmbahet kërkesës së pyetjes.

3 pikë	Nëse përcakton tri masat.
OSE	
2 pikë	Nëse përcakton dy nga masat.
1 pikë	Nëse përcakton një nga masat.
0 pikë	Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 34

Model përgjigjeje

- a) Konfrontimi midis dy superfuqive do të zhvillohej në planin ideologjik, politik, ekonomik, ushtarak etj.
- b) Luftuan për të krijuar epërsi në garën e armatimeve, të bazuara në armët bërthamore. Kështu në gusht të vitit 1949 BS prodhoi bombën atomike e më pas atë me hidrogjen, gjë që i dha fund monopolit amerikan atomik
- c) Krijimi i blloqeve ushtarake si NATO dhe Traktati i Varshavës. Në prill të vitit 1949 SHBA-ja dhe vendet e Evropës Perëndimore krijuan Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO). Aleanca u zotua për t'i dhënë ndihmë çdo shteti anëtar, në rast se ndaj tij do të merrej ndonjë agresion i armatosur. Ndërkaq BS iu përgjigj me krijimin e aleancës ushtarake të Traktatit të Varshavës në vitin 1955, shtete anëtare të së cilës ishin vendet e bllokut komunist.
- d) Të dy superfuqitë u ballafaquan në mënyrë indirekte edhe ushtarakisht (Lufta Civile në Greqi, Lufta e Koresë, kriza kubane)
- e) Ndërtimi i Murit të Berlinit në vitin 1961, i cili vërtetoi në mënyrë simbolike thënien e Çërçillit për "perden e hekurt".

Shënim: Pranohet çdo lloj përgjigjeje që i përmbahet kërkesës së pyetjes.

4 pikë	Nëse identifikon dy nga aspektet e konfrontimit, duke i shpjeguar ato.
OSE	
3 pikë	Nëse identifikon dy nga aspektet e konfrontimit, dhe shpjegon një të një prej tyre.
2 pikë	Nëse identifikon dy nga aspektet e konfrontimit.
1 pikë	Nëse identifikon një nga aspektet e konfrontimit.
0 pikë	Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

QSHA 2021